VENDIM
Nr.1249, datë 16.12.2009

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT (KNMSHPD)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD) kryesohet nga ministri i Shëndetësisë dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Brendshëm ;
- Zëvendësministrin e Mbrojtjes;
- Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Kryetarin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit;
- Drejtorin e Policisë së Shtetit ;
- Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;
- Kryetarin e Shoqatës së Bashkive.

2. KNMSHPD-ja ka për detyrë:

- të orientojë politikat dhe strategjitë për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga produktet e duhanit ;
- të propozojë rishikimin e akteve, ligjore dhe nënligjore, në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të publikut nga produktet e duhanit;
- të propozojë programe dhe projekte për të siguruar uljen e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, si dhe t'i monitorojë e vlerësojë ato;
- të angazhohet për orientimin e burimeve dhe të projekteve, që synojnë uljen e përdorimit të produkteve të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit prej tyre;
- të përcaktojë formën dhe tekstin e mesazheve në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit, të cilat i përditëson të paktën çdo dy vjet;
- të sigurojë një bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe joqeveritare brenda dhe jashtë vendit për politikat e kontrollit të duhanit;
- të raportojë, nëpërmjet kryetarit, çdo vit, te komisioni parlamentar përkatës.

3. KNMSHPD-ja mblidhet jo më pak se 4 herë në vit dhe thirret nga kryetari, i cili, 5 ditë para mbledhjes, u njofton anëtarëve rendin e ditës dhe u dërgon atyre materialet përkatëse.

4. Mbledhjet janë të vlefshme, kur marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazimi të votave "pro" dhe "kundër", vota e kryetarit është përcaktuese.

5. Pranë Institutit të Shëndetit Publik, ngrihet sekretariati teknik i këtij komiteti për mbështetjen teknike të tij. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tij përcaktohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve për çdo mbledhje është 5 000 (pesë mijë) lekë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

8. Vendimi nr.113, datë 17.2.2007 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin, funksionimin, përbërjen dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD)", shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha